



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:107811

Datë: 15.01.2024

Numri i dokumentit: 05191019

C.nr.2790/2023

GJYKATA THEMELORE E P...S - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.Xh. nga P..., të cilën me autorizim e përfaqëson av. T.I. nga P..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në P..., me objekt të kontestit për kompensimin e dëmit material, jashtë seancës me datë 09.01.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses D.Xh. nga P..., me të cilën kanë kërkuar kompensimin e dëmit material ne aksidentin e shkaktuar me datën 29.04.2023, në shumën prej 1,000.00euro, edhe këtë me kamat ligjore prej 8 % në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja D.Xh. nga P..., përmes të autorizuarit të tije ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 15.05.2023, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në P..., me objekt të kontestit për kompensimin e dëmit material, ne emër të aksidentit të shkaktuar me datën

29.04.2023, në shumën prej 1,000.00 euro edhe këtë me kamat ligjore prej 8% në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit

I autorizuar i paditëses me parashtrësën e datës 09.01.2024 i ka deklaruar gjykatës së heq dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga nenit 149 dhe 388, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si pikën një të dispozitivit të aktgjykimit.

Vendimin që pala paditëse t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE E P...S

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 2790/2023, më datë 09.01.2024

GJYQTARI

PËRPARIM ZEKA

KESHILLE JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë